



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1635/6 prot.

Tiranë, më 14.07.2026

REKOMANDIM

Nr. 39, datë 14.07.2026

PËR KONTROLLUESIN, SHOQËRIA “AUTO SALLON PALMANOVA” SHPK

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Auto Sallon Palmanova” sh.p.k. (në vijim “Kontrolluesi”),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 133, datë 12.06.2026, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi në kuadër të zbatimit të detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L72021003N, me objekt aktiviteti “Koncesionar, auto sallon dhe tregtimin e mjeteve motorike rrugore, duke përfshirë importin dhe eksportin e tyre me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve etj.”.

“Auto Sallon Palmanova” sh.p.k. është një shoqëri tregtare e specializuar në fushën e tregtimit të automjeteve, e cila ofron shërbime të shitjes së automjeteve dhe shërbime të lidhura me to, si dhe përfaqëson marka të autorizuar të automjeteve, në përputhje

me legjislacionin e zbatueshëm dhe standardet e prodhuesit. Në kuadër të veprimtarisë që ushtron, Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “klientë”, “furnitorë”, “aplikantë për punësim” etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video-survejitimit (CCTV), përmes të cilit kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtron veprimtarinë e tij.

Nga analizimi i planvendosjes së kamerave, konstatohet se disa prej tyre janë të instaluar dhe orientuara në mënyrë të tillë që monitorojnë ambientet e jashtme të ndërtesës, duke përfshirë edhe ambiente të tjera, si rrugë kalimi dhe ambientet e posteve të punës, në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Ligjit, Udhëzimin nr. 03, datë 30.04.2025 “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejitimit” (në vijim “Udhëzimi nr. 3”) dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video-survejitimit CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si “imazhe” e “video”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parimet e përpunimit të parashikuara në nenin 6 të Ligjit, si ligjshmëria, drejtësia dhe transparenca, kufizimi i qëllimit, minimizimi i të dhënave, saktësia, kufizimi i afatit të ruajtjes, integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Në rastin konkret, vendosja e kamerave me orientim në hapësira publike sjell përpunim të paligjshëm, pasi Kontrolluesi nuk ka arritur të provojë se mbështetet në një kriter të qartë ligjor, sipas parashikimeve të nenit 7 të Ligjit.

3. Nga verifikimi në faqen zyrtare <https://autopalmanova.al>, rezulton se Kontrolluesi ka hartuar dhe publikuar rubrikën “Politikat e Privatësisë”, të cilat janë modele standarde/template të politikave të privatësisë.

Konstatohet se Kontrolluesi nuk informon në gjuhën shqipe, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, subjektet e të dhënave (klientë, vizitorë, punonjës etj.), për qëllimet e përpunimit për të cilat janë të destinuara të dhënat personale, si dhe bazën ligjore për përpunimin e tyre, mënyrën e përpunimit, personin që do t’i përpunojë ato, të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave të Kontrolluesit, periudhën e mbajtjes së tyre apo në mungesë të saj kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë periudhë, si dhe masat e sigurisë që garantojnë mbrojtje të përshtatshme të të dhënave personale që përpunohen, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se faqja zyrtare e internetit përbën zakonisht pikën e parë të kontaktit ndërmjet Kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave, ndaj mungesa e një politike ose publikimi i saj në mënyrë jo të plotë i kufizon informacionin e

nevojshëm të subjekteve mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

Gjithashtu, publikimi i rubrikës “Politikat e Privatësisë” është thelbësor për ushtrimin efektiv të të drejtave të subjekteve të të dhënave. Vetëm përmes informimit të plotë sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit, subjektet e të dhënave mund të njihen me të drejtat e tyre dhe mënyrën për t’i ushtruar ato, duke shmangur situatat ku këto të drejta mbeten formale dhe të pazbatueshme në praktikë. Njëkohësisht, ato shërbejnë si mjet parandalues ndaj praktikave joligjore ose të njëanshme të Kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Kontrolluesi, pjesë e dokumentacionit në funksion të përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale evidentohet formati/template “Deklaratë Konfidencialiteti dhe mbrojtjeje të informacionit”. Megjithatë, nga verifikimi i dosjeve të punonjësve dhe akteve në tërësi rezultoi se Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit, të cilët kanë akses në informacionin e mbajtur nga ana e tij “Deklaratën e Konfidencialitetit”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 30 i Ligjit, si dhe Vendimi nr. 6, datë 05.08.2013, i Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim “Vendimi nr. 6”), me qëllim marrjen e përgjegjësisë së plotë në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale dhe ruajtjen e tyre.

Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i nënshkrimit të “Deklaratës së Konfidencialitetit” është garantimi i ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë së çdo nëpunësi që ka akses në të dhëna personale, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kufijtë e përpunimit të lejuar, ndalimin e përdorimit të të dhënave për qëllime personale apo të paautorizuara, detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës. Ky instrument përbën një masë thelbësore organizative në kuadër të parimit të përgjegjshmërisë, duke dokumentuar faktin se Kontrolluesi ka marrë masa konkrete për të garantuar përpunimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 30 të Ligjit.

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se Kontrolluesi disponon aktet e brendshme “Politika e mbrojtjes së të dhënave personale” dhe “Politika e sigurisë së informacionit”. Megjithatë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre akteve, si dhe nga analizimi në tërësi i provave të mbledhura gjatë hetimit administrativ, rezulton se në to nuk janë të parashikuara rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe procedura organizative mbi mënyrën e përpunimit të tyre, si mënyra e mbledhjes, regjistrimit, ruajtjes dhe asgjësimit të tyre, sigurinë e të dhënave personale, aksesin në të dhënat personale, afatet e mbajtjes së të dhënave, që nuk janë pjesë e sistemit CCTV etj., sipas parashikimeve të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese që kryen.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përshtatja dhe plotësimi i dokumentit “Politika e mbrojtjes së të dhënave personale”, me të gjitha elementet ligjore të përcaktuara në

pikën 1 të nenit 27 të Ligjit, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, në aktin e brendshëm duhet të përcaktohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura organizative për të gjitha aspektet e përpunimit të të dhënave, duke përfshirë mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë fizike, teknike dhe administrative, ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave, aksesin, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave.

6. Rezulton se Kontrolluesi nuk ka marrë masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, duke përfshirë, ndër të tjera, *pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale; aftësinë për të garantuar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit; aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale brenda një kohe të arsyeshme në rast incidenti fizik ose teknik; një proces për testimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e rregullt të efikasitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit* etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr.6, datë 05.08.2013, të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.

Gjithashtu, konstatohet se Kontrolluesi nuk mban dokumentacion mbi veprimtaritë e përpunimit, me qëllim demonstrimin e përputhshmërisë me Ligjin, në formë të shkruar dhe në format elektronik, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit.

Referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion në format të shkruar dhe elektronik për veprimtaritë e tij përpunuese, në mënyrë që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë me këtë Ligj. Referuar nenit 27, pika 4 e Ligjit, çmohet se Kontrolluesi nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përjashtuara nga detyrimet e nenit 27, pikat 1 dhe 2 të Ligjit pasi, edhe pse ka më pak se 250 (dyqind e pesëdhjetë) persona të punësuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij të biznesit ai bën përpunim të rregullt e të shtrirë në kohë (pra jo rastësor) për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “klientë” etj. (shih pika 4 e nenit 27 të Ligjit).

Mungesa e këtij dokumentacioni dhe mosrespektimi i procedurave të brendshme rregullatore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, sipas kërkesave të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit, demonstroi mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontrolluesi, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë së tij, nuk ka marrë masa për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme një Sistem Menaxhimi të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System “PIMS”*), sipas Udhëzimit nr. 09, datë 20.11.2025 “Për kriteret e përgjithshme

për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale” (në vijim “Udhëzimi nr. 09”).

Kuadri ligjor evropian mbi mbrojtjen e të dhënave personale, të cilin Ligji transponon, dhe praktika më e mirë evropiane e konsideron certifikimin si një mekanizëm përputhshmërie me Ligjin¹ dhe për të inkurajuar zbatimin e tij, i krijon rast pas rasti kontrolluesve që e zbatojnë atë në mënyrë efektive, një pozitë preferenciale në kryerjen e disa veprimtarive përpunuese të caktuara, siç janë për shembull transferimet ndërkombëtare. Në këtë kuadër, në zbatim të nenit 37 të Ligjit, i cili parashikon dhe rregullon mekanizmin e certifikimit, Komisioneri ka miratuar Udhëzimin nr. 08, datë 20.11.2025 “Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues” (në vijim “Udhëzimi nr. 08”) dhe Udhëzimin nr. 09.

Udhëzimi nr. 09 referon në Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System “PIMS”*) dhe Komisioneri inkurajon kontrolluesit, të cilët për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre e kanë të nevojshme ngritjen e një sistemi të tillë, me qëllim standardizimin dhe rregullimin e veprimtarisë përpunuese dhe garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, të zbatojnë Udhëzimet nr. 08 dhe nr. 09.

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë një sistem menaxhimi të të dhënave personale (PIMS), në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 09.

Bazuar në nenin 28 të Ligjit dhe nenin 13 të Udhëzimit nr. 09, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete teknike dhe organizative, që garantojnë nivel të përshtatshëm për rrezikun, masa të cilat duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm.

7. Nga verifikimi *on-site* i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, si dhe nga shqyrtimi i procedurave rregulluese që disponon Kontrolluesi, rezulton se:

- Nuk ka plane të dokumentuara për menaxhimin e riskut, teknikat e menaxhimit dhe të performancës;
- Nuk ka të hartuar planin e politikave të vazhdueshmërisë së biznesit, dokumente këto që do të duhet të përmbanin politikat dhe objektivat që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës;
- Nuk ka të specifikuar/dokumentuar kohën maksimale në të cilën shërbimet dhe sistemet nuk mund të jenë funksionale. Nuk janë planifikuar masa që në rast dështimi të një/disë pajisjeve të mos ndikohen në funksionimin e sistemeve dhe shërbimeve të ofruara;

¹ Pika 3 e nenit 22, pika 3 e nenit 28

- Nuk ka kryer auditime të brendshme me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të këtyre teknikave për menaxhimin e riskut (ose në mungesë të teknikave, identifikim të riskut);
- Politikat mbi gjurmët (*log-et*) për infrastrukturën mbështetëse TIK, nuk zbatohen sipas një procedure të rregulluar, me risk në qasje të paautorizuar në të dhëna, kërcënim të sigurisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe mungesë transparence.

Gjithashtu, konstatohet se masat e ndërmarra në drejtim të *backup*-it janë të pamjaftueshme dhe nuk japin siguri në mbështetjen e planit të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) dhe planit të rimëkëmbjes nga katastrofa (DRP), në kundërshtim kjo me masat e sigurisë së informacionit. Nuk u gjetën procedurat e rikrijimit (*restore*) të *backup*-it të të dhënave, me qëllim testimin e tyre, për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar. Këto procedura duhet të testohen rregullisht, sistematikisht dhe vazhdimisht.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mungesa e një plani të strukturuar për menaxhimin e riskut, e reflektuar në moshartimin e procedurave për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve, si dhe në mungesën e auditimeve të brendshme dhe monitorimit të vazhdueshëm të masave të sigurisë, cenon drejtpërdrejt parimin e llogaridhënies, sipas nenit 6 dhe detyrimet e nenit 28 të Ligjit. Pa një analizë të bazuar në risk, Kontrolluesi nuk është në gjendje të përcaktojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, duke krijuar ekspozim të lartë ndaj incidenteve të sigurisë, aksesit të paautorizuar dhe përpunimeve të paligjshme të të dhënave personale.

Në të njëjtën kohë, mungesa e planeve të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) dhe e planeve të rikuperimit nga katastrofat (DRP), si dhe mospërcaktimi i parametrave kritikë, si koha maksimale e ndërprerjes së shërbimeve (RTO/RPO), tregojnë një mungesë të planifikimit për garantimin e disponueshmërisë dhe integritetit të të dhënave. Këto mangësi rrisin ndjeshëm rrezikun që, në rast dështimi teknik apo incidenti kibernetik, të dhënat personale të mos rikuperohen brenda një afati të pranueshëm ose të humbasin në mënyrë të pakthyeshme, duke cenuar të drejtat dhe interesat e subjekteve të të dhënave.

Gjithashtu, mungesa e procedurave të rregulluara për administrimin e *log*-eve dhe pamjaftueshmëria e masave të *backup*-it, e shoqëruar me mungesën e testimit të rregullt të rikthimit të të dhënave (*restore*), tregon se masat e sigurisë janë të paplota dhe jo efektive në praktikë. Në këto kushte, Kontrolluesi nuk garanton gjurmueshmërinë e veprimeve mbi të dhënat, transparencën dhe aftësinë për të reaguar ndaj incidenteve, duke qenë në kundërshtim me kërkesat e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

8. Konstatohet se Kontrolluesi ka caktuar koordinatorin e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale me Vendimin e datës 05.01.2026, nëpërmjet të cilit e ngarkon edhe me detyrat përkatëse sipas parashikimeve të Ligjit. Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për informim nëpërmjet publikimit të të dhënave të tij në faqen zyrtare të internetit me qëllim që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë për çështje që lidhen me proceset përpunuese dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, si dhe nuk ka kryer njoftimin pranë Komisionerit për caktimin e tij, sipas pikës 3 të nenit 34 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në pikën 3 të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të publikuar të dhënat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre sipas këtij Ligji, si dhe për t'ia njoftuar ato Zyrës së Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare dhe në formë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 08.07.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë së cilës ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të siguruar që çdo mangësi të adresohet në përputhje me Ligjin.

Gjithashtu, nga ana e Kontrolluesit, me shkresën e administruar me tonën nr. 1635/5 prot., datë 8.7.2026, janë përcjellë pretendimet me shkrim lidhur me gjetjet e procesverbalit të hetimit administrativ.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 13, 27, 28, 30, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Kontrolluesi, shoqëria “Auto Sallon Palmanova” sh.p.k., të ketë në vëmendje përcaktimin e planeve të kamerave përmes sistemit të video-survejimit (CCTV), në përputhje me parashikimet e neneve 6 dhe 7 të Ligjit.

2. Kontrolluesi, shoqëria “Auto Sallon Palmanova” sh.p.k., të ketë në vëmendje përditësimin dhe publikimin në gjuhën shqipe të rubrikës “Politikat e Privatësisë”, në faqen zyrtare <https://autopalmanova.al>, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, shoqëria “Auto Sallon Palmanova” sh.p.k., në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e aktit të brendshëm rregullator “Politika e mbrojtjes së të dhënave personale”, duke parashikuar në të masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, përcaktimin e niveleve të aksesit etj.;
4. Kontrolluesi, shoqëria “Auto Sallon Palmanova” sh.p.k., në zbatim të nenit 30 të Ligjit, të marrë masa hartimin dhe aplikimin e “Deklaratës së Konfidencialitetit” për punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
5. Kontrolluesi, shoqëria “Auto Sallon Palmanova” sh.p.k., të marrë masa për publikimin e të dhënave të kontaktit të nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale në faqen zyrtare të internetit <https://autopalmanova.al>;
6. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - i) vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 më sipër;
 - ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 4 më sipër;
 - iii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 5 më sipër.Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
7. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;
8. Komisioneri, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me Ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 14.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi